



SYLLABUSI I LËNDËS “BAZAT E BARTJES SË INFORMACIONIT”

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike		
Titulli i lëndës:	Bazat e bartjes së informacionit		
Programi:	Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikimi		
Niveli:	Baçelor		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	1		
Numri i orëve në javë:	2+2 (ligjërata dhe ushtrime)		
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS		
Koha / lokacioni:	Të publikuara në web site të universitetit!		
Mësimdhënësi i lëndës:	Ph. D. c. Arbër Beshiri		
Të dhënat kontaktuese:	arber.beshiri@uni-prizren.com		
Përshkrimi i lëndës:	Lënda ofron koncepte bazë rreth hapave për bartjen e informacioneve, informacionin si tërësi dhe sinjalet, llojet e transmetimit, modulimet transmetuese të informacionit, llojet e modulimeve, demodulimet, llojet e rrjeteve dhe aplikimi i tyre, rrjetet optike dhe standardet e tyre, llojet e modulimeve optike, mediumet për transmetimin e informacioneve, etj.		
Qëllimi i lëndës:	Përmes kësaj lënde mundësohet që studentët të kuptojnë hapat që nevoiten për bartjen e informacionit nga burimi deri tek destinacioni; dallimin ndërmjet informacionit, mesazhit dhe të dhënave; teknologjitë e ndryshme të medimeve transmetuese, modulimit të informacioneve dhe rrjeteve; rrjetet optike dhe teknologjitë e ndryshme që aplikohen në këto rrjete, etj.		
Rezultatet e të nxënit:	Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do jetë në gjendje: <ul style="list-style-type: none">• Të kuptojnë teknologjitë për transmetimin e informacioneve.• Të kuptojë llojet e rrjeteve dhe medimeve transmetuese.• Të kuptojë dhe aplikojë teknologjitë për modulimin e informacioneve dhe të bëj dallimin në mes të informacionit, të dhënës, mesazhit dhe hapat që duhet ndërmarrë për bartjen e tyre përmes pajisjeve adekuatë për transmetim të informacioneve, rrjetit dhe të dhënave.		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/ javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren	1	1	1
Kollokfiume, seminare	2	2	4



Detyra të shtëpisë	2	2	4
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja përfundimtare për provim	5	6	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj	4	2	8
Totali			150 orë (6 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	Lënda është kombinim i ligjëratave, diskutimeve, ushtrimeve numerike dhe laboratorike, ndërsa detyrat prezantohen nga mësimdhënësi në laborator.		
Metodologjia e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Detyrat laboratorike: 20%. • Kollokviumi 1: 40%. • Kollokviumi 2: 40%. • Ose provimi përfundimtar: 100%. 		
Literatura			
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Behrouz A. Forouzan. Data Communications and Networking with TCP/IP Protocol Suite, 6th Edition, McGraw-Hill, 2021. 2. Behrouz A. Forouzan. Data Communications and Networking, 5th Edition, McGraw-Hill, 2013. 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Curt M. White. Data Communications and Computer Networks - A Business User's Approach, 8th Edition, Cengage Learning, 2016. 		

Plani i dizajnuar i mësim:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i syllabusit (rreth ligjëratave). • Hyrje në bazat e bartjes së informacionit (kapitulli 1). 	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i syllabusit (rreth ushtrimeve). • Hyrje në bazat e bartjes së informacionit.
<i>Java e dytë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Modelet e rrjeteve kompjuterike (kapitulli 2). 	<ul style="list-style-type: none"> • Modelet e rrjeteve kompjuterike.
<i>Java e tretë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Shtresa fizike e rrjeteve kompjuterike (kapitulli 3). 	<ul style="list-style-type: none"> • Shtresa fizike e rrjeteve kompjuterike.
<i>Java e katërt:</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Transmetimi analog (kapitulli 4). 	<ul style="list-style-type: none"> • Transmetimi analog.
<i>Java e pestë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Transmetimi digjital (kapitulli 5). 	<ul style="list-style-type: none"> • Transmetimi digjital.
<i>Java e gjashtë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i bandwidth-it - multipleksimi dhe spektri i shpërndarjes së sinjalit (kapitulli 6). 	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i bandwidth-it – multipleksimi dhe spektri i shpërndarjes së sinjalit.
<i>Java e shtatë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Mediat për transmetim (kapitulli 7). 	<ul style="list-style-type: none"> • Mediat për transmetim.
<i>Java e tetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Kollokviumi 1. 	<ul style="list-style-type: none"> • Konsultime rreth kollokviumit të parë.

<i>Java e nëntë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> Metodat për bartjen e informacioneve - Switching (kapitulli 8). 	<ul style="list-style-type: none"> Metodat për bartjen e informacioneve - Switching.
<i>Java e dhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> LAN-et - Etherneti (kapitulli 13). Llojet tjera të rrjeteve kabllore (kapitulli 14). 	<ul style="list-style-type: none"> LAN-et - Etherneti. Llojet tjera të rrjeteve kabllore.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> Pajisjet konektuese (komunikuese) dhe LAN-i virtual (kapitulli 17). Shtresa e rrjetit (kapitulli 18). 	<ul style="list-style-type: none"> Pajisjet konektuese (komunikuese) dhe LAN-i virtual. Shtresa e rrjetit.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> Protokolet e shtresës së rrjetit (kapitulli 19) Rutimi unicasting dhe multicasting (kapitulli 20 dhe 21). 	<ul style="list-style-type: none"> Protokolet e shtresës së rrjetit. Rutimi unicasting dhe multicasting.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> Shtresa e transportit (kapitulli 23). Protokolet e shtresës së transportit (kapitulli 24). 	<ul style="list-style-type: none"> Shtresa e transportit. Protokolet e shtresës së transportit.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> Protokolet e standardit klient-server (kapitulli 26). Paradigma peer-to-peer (kapitulli 29). 	<ul style="list-style-type: none"> Protokolet e standardit klient-server. Paradigma peer-to-peer.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> Kollokviumi 2. 	<ul style="list-style-type: none"> Konsultime rreth kollokviumit të dytë.
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		
<ul style="list-style-type: none"> Në përgjithësi prezantimet e ligjëratave do të bëhen përmes MS PowerPoint, tabelës, përdorimit të materialeve, programeve kompjuterike dhe ushtrimeve numerike. Po ashtu, nga mësimdhënësit do të sigurohen edhe materiale tjera shtesë (punime shkencore, publikime, buletinet nacionale, si dhe zbulimet dhe hulumtimet e fundit). Në mungesë të mundësisë që puna praktike të organizohet çdo javë, në bashkëpunim me menaxhmentin e universitetit, ky aktivitet do të organizohet në ditë të caktuara në: organizata, kompani, njësitë prodhuese-përpunuese, etj. Gjatë çdo seancë do të organizohet qasja e bashkëbisedimit dhe bashkëparticipimit me studentë! Nga studentët kërkohet që të jenë të rregullt në ligjëratat dhe ushtrimet! Do të vlerësohet kontributi i studentëve kur ata bashkëpunojnë dhe participojnë në ligjëratat dhe ushtrimet e lëndës! Ardhja e studentëve me kohë në ligjëratat dhe ushtrimet është e obligueshme! 		